

Syllabus i lëndës

Lënda: **AKAID – SEKTET DHE DHKOLLAT ISLAME**

Programi i studimit: **Teologji**

Numri i ECTS kredive: **7 ECTS Kredi**

Niveli dhe lloji i lëndës: **Obligative**

Kodi i lëndës: **308**

Fondi i orëve: **3+2 (semestri VI)**

Profesori: **Prof. ass. dr. Zija Abdullahu**. Kontakti: e-maili: **zabdullai@hotmail.com**

Qëllimi i lëndës

Pajisja e studentëve me njohuri bazë nga lëmi i Sekteve dhe shkollave islame, duke studiuar sektet më të rëndësishme gjatë historisë dhe ato aktuale në botën islame. Zhvillimi i shkathtësive dhe aftësive për të analizuar të dhënat e sekteve të ndryshme të cilat përfshinë programi studimor në mënyrë që të mund të nxjerrin konkluzione për gabimet dhe sukseset që kanë korrur këto sektet gjatë historisë. Fitimi dhe avancimi i sensit kritikë në aspektin e vlerësimit të argumenteve bazuar në fakte përkatëse islame ndaj këtyre sekteve. Aftësimi për të shkruar ese apo për të diskutuar për to, në një stil të pastër dhe bindës të të shprehurit me gojë dhe me shkrim, tipare këto të një personi me një edukim liberal akademik. Prej leksioneve nga lëmi i Sekteve dhe shkollave islame presim që studenti pas përfundimit të këtij kursi do të përfitojë njohuri të bollshme mbi sektet gjatë historisë dhe ato më dominuese në botën islame, e në veçanti njohuri për sektet që gjenden në trojet tona, me të cilat bashkëjetojmë, t'i njohë të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet tyre. Të kuptojë proceset e zhvillimit që nga formimi i tyre e deri në ditët e sotme. T'i jepet mundësi studentit që në formë kritike duke nxitë debate, t'i kuptoj se çështjet e përbashkëta që i afrojnë mes veti sektet janë shumë më shumë se ato që i ndajnë. Të kuptojë se zhvillimi i sekteve në fe të ndryshme, në këtë rast edhe në atë islame është një fenomen natyrorë, prandaj duhet të shërbej në ngritjen e tolerancës në shoqëri, dhe se studimi i sekteve duhet të zhvillohet dhe të avancohet ditë e më shumë, mbase është në interes të bashkëjetesës dhe të paqes në rajon dhe në botë.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të kursit, studenti do të jetë në gjendje të:

Të përshkruaj etapat e zhvillimit të sekteve gjatë historisë si dhe ato më dominuese në botën islame.

Të krahasoj ndërmjet sekteve të ndryshme të cilat i studion gjatë kursit.

Të diskutoj rreth këtyre sekteve në bazë të argumenteve të secilit sekt, duke qenë sa më objektiv në parashtrimin e tyre.

Të mbroj qëndrimet e secilit sekt, ashtu siç i konceptojnë ithtarët e tyre.

Të prezantoj mendimin kritik ndaj secilit prej tyre, duke ia parashtruar argumenteve të shëndosha islame.

Të jetë në gjendje që njohuritë e fituara t'i aplikoj në relacionet ndërsektare.

Metodologjia e mësimdhënies:

Mësimi do të zhvillohet në formë të ligjëratave, stimulimit të studentëve në diskutime interaktive, duke bërë pyetje dhe analiza në kuadër të ligjëratës së mbajtur. Po ashtu do të mbahen seminare dhe ese të ndryshme, të cilat do të prezantohen në mënyrë individuale por edhe grupore, dhe teste të vlerësimit. Gjithashtu studentët kanë mundësi që gjatë përgatitjes së lëndës të kontaktojnë me profesorin dhe të marrin udhëzime me qëllim të arritjes së cilësisë dhe rezultateve në mësim dhe sukses të studentëve.

Përmbajtja e lëndës:

Java e pare: *HYRJE*, njohja me syllabusin, metoda, organizimi, kërkesat dhe vlerësimi.

Shqyrtime të përgjithshme: Sektet si fenomen mbarë fetarë në fe të ndryshme.

Kontributi i dijetarëve islam të mëhershëm për sektet dhe fraksionet islame.

MOSPAJTIMI SI DUKURI MBARNJERËZORE. Terminologjia: Fraksion, doktrinë, sekt, medh'heb, dhe shkollë. Mospajtimit ndërnjerëzore.

Propozimi i temave për punime seminarike dhe për ese.

Literatura: Dr. Zija Abdullahu, *Sektet dhe shkollat islame*, f. 3-11. (Në vazhdim do të jetë kjo literaturë bazë, andaj do të mjaftohemi vetëm me cekjen e faqeve).

Java e dyte: *SHKAQET E PËRGJITHSHME TË MOSPAJTIMEVE NDËRNJERËZORE*: Paqartësia e tematikave diskutuese. Fanatizmi në mendimet e trashëguara. Ndryshimi i kulturave dhe metodologjisë së studimit. Ambiciet (dëshirat). Dashuria për pushtet dhe pozitë. *SHKAQET E VEÇANTA TË PËRÇARJES NDËRMJET MUSLIMANËVE*: Fanatizmi ndër fisnorë, çështja e kalifatit, hyrja në Islam nga fetë tjera, ajetet me më shumë kuptime (*muteshabihat*), përkthimi i librave filozofik, treguesit e përrallave, ndryshimet në shkollat juridike të fikhut. Bisedë interaktive, rreth shkakut më kryesorë dhe më aktual të përçarjes ndërmjet muslimanëve

Literatura: (f. 12-19)

Java e trete: *MANIFESTIMI I PËRÇARJES NDËRMJET MUSLIMANËVE*. Grupet politike. Qëndrimi i Kur'anit dhe Sunetit ndaj politikës apo halifatit: drejtësia, kuvendi konsultativ (*Shura*), respekti i të zgjedhurit. Leximi i punimeve seminarike dhe eseve dhe diskutimi rreth tyre.

Literatura: (f. 20-24).

Java e katërt: *MANIFESTIMI PRAKTIK I PËRÇARJES NDËRMJET MUSLIMANËVE*. Përçarja e muslimanëve rreth halifatit. Shkaqet e rebelimit në periudhën e h. Osmanit. *LUFTAT NXITËSE TË SHFAQJES SË SEKTEVE*: Lufta e Devesë. Lufta e Sifinit. Paraqitja e sekteve në skenën shoqërore. Bisedë interaktive, rreth pasojave të rënda nga kjo përçarje.

Literatura: (f. 25-32).

Java e pestë: *HARIXHITËT*. Zanafilla, parimet, shtrirja aktuale. *SHI-IZMI*. Parimi kryesorë i Shi'izmit. Situata nën të cilën është formuar ky sekt. Vendbanimet e shiave. Faktorët nga të cilët janë ndikuar shiat. Bisedë interaktive, rreth ndikimeve të shi-itëve nga situatat dhe trashëgimitë e mëparshme.

Literatura: (f. 33 -40).

Java e gjashtë: *SHITËT EKSTREM*. Grupet e zhdukura të shi-itëve ekstrem: Seb'itët, Gurabitët. Bejanitët. Mugiritët. Kisanijtë. Leximi i punimeve seminarike dhe eseve dhe diskutime rreth leksioneve nga orët e mëparshme.

Literatura: (f. 48-56).

Java e shtatë: *SHITËT LIBERAL (TË RËNDOMTË)*. Zejditë: zanafilla, themeluesi, parimet, shtrirja aktuale. *IMAMIJTË\ITHNAASHERIJTË*: zanafilla, themeluesi, parimet, shtrirja aktuale. Debat rreth afërsisë së Shiave Zejditë me *Ehli Sunetin* Propozimi i temave për punime seminarike dhe për ese.

Literatura: (f. 57-67).

Java e tetë: *JAVA E KOLOVIUMEVE*

Java e nëntë: *GRUPET E SHI-ITËVE EKSTREME EKZISTUESE*: Imamijtë, Ismailijtë - Batinijtë. Durzitët: zanafilla, themeluesi, parimet, shtrirja aktuale. Bisedë interaktive, rreth aktivitetit të tyre politikë e sidomos në Liban

Literatura: (f. 68-72).

Java e dhjetë: *NUSAJRITËT/ALEVITËT*. Zanafilla, themeluesi, parimet, shtrirja aktuale. Babizmi. Behaizmi. Zanafilla, themeluesi, parimet, shtrirja aktuale. Analiza e rezultateve të testit të mbajtur me anë të bisedës interaktive

Literatura: (f. 73-78).

Java e njëmbëdhjetë: *AHMEDITË/KADIANITË*: Zanafilla, themeluesi, parimet, shtrirja aktuale, dhe aktiviteti i tyre në trojet tona. **MANIFESTIMI TEORIK I PËRÇARJES NDËRMJET MUSLIMANËVE**. Murxhitët. Xhebrijtë. Kaderitë. Bisedë interaktive rreth krahasimit të botimit të Kuranit në gjuhën shqipe nga Ahmedijtë.

Literatura: (f. 79-90).

Java e dymbëdhjetë *MU'TEZILËT*: Zanafilla, themeluesi, parimet, shtrirja aktuale. **EHLU SUNETI DHE XHEMATI**. *ESH'ARITË*. Zanafilla, themeluesi, parimet, shtrirja aktuale. *MATURIDITË*: Zanafilla, themeluesi, parimet, shtrirja aktuale. Bisedë interaktive për shkaqet e shuarjes së Mu'tezilëve, dhe përhapjes së shpejtë të Esh'arizmit dhe Maturidizmit.

Literatura: (f. 90-102).

Java e trembëdhjetë: *SELEFIZMI*. Zanafilla, themeluesi, parimet, shtrirja aktuale. *SUFIZMI* dhe tarikatet në trojet tona: tarikati: Bektashi, Halveti, Kadiri, Rifai, Melamij, Mevlevij, Nakshibendijë. Diskutime rreth Sufizmit të real dhe atij të paraqitur në trojet tona.

Java e katërdhjetë: *QËNDRIMI ISLAM NDAJ TARIKATEVE*. Diskutime rreth leksioneve nga orët e mëparshme.

Literatura: (f. 103-120).

Kriteret dhe komponentët e vlerësimit:

Prezantimi dhe aktiviteti gjatë orës: **10 pikë**

Punimi seminarik: **10 pikë**

Vlerësimi i testit të parë: **40 pikë**

Provimi final: **40 pike**

Standardi i notimit në FSI:

10= 90% - 100%. SHKËLQYESHËM- njohuri të shkëlq. me vetëm disa gabime minore.

9= 81 – 89. SHUMË MIRË – mbi mesatare standarde, por me disa gabime.

8=71 – 80. MIRË – rezultat në përgjithësi i mire me disa gabime që vërehen.

7=61 – 70. KËNAQSHËM – mire,por me mjaft gabime.

6=51 – 60. MJAFTON – rezultatet plotësojnë kriteret minimale.

5=0 – 50. DOBËT – kërkohet shumë punë për të fituar kredi.

Literatura themelore:

Dr. Zija Abdullahu, *Sektet dhe shkollat islame*, dispensë për vitin e tretë (për përdorim vetëm të brendshëm), Fakulteti i Studimeve Islame.

Literatura plotësuese:

1. Kur'ani i nderuar.
2. Murtezai, dr. Ekrem; *“Fjalor i feve”*, Prishtinë, 2000.
3. Topaloglu, dr. Bekir; *“Hyrje në kelam”*, përkth. Mit'hat Hoxha, Prishtinë, 2002.
4. Tërnavë, Naim; *“Fraksionet në Islam”*, Prishtinë, 1997.
5. Rexhepagiqi, Jashar; *“Dervishët dhe teqet”*, Pejë, 2003.
6. Grup autorësh, *“Besimet e sekteve muslimane dhe pagane fraksionet islame”*, Gjilan, 1997.
7. Ahmeti, Bajrush, *“Vështrim kulturo-historik mbi formimin dhe përhapjen e disa fraksioneve në historinë islame*, Prishtinë, 2007.
8. Ibrahim, Nexhat, *“Zhvillimi i sekteve në historinë e mendimit islam”*, Tetovë, 2007.
9. Dr. Beheshti dhe Dr. Bahonar; *“Filozofia Islame”*, përkth. Dr. Sokrat Ahmataj. Tiranë, pa datë.
10. Izeti, mr. Metin; *“Tarikati Bektashian”*, Tetovë, 2001.
11. Yilmaz, H. Kamil; *“Hyrje në tesavvuf”*, përkth. Metin Izeti, Tetovë, 2002.
12. Corbin, Henry; *“Historia e filozofisë Islame”*, përkth. nga boshnj. Nexhat Ibrahim, Shkup, 1997.
13. Ahmed, Mirza Ghulam; *“Filozofia e mësimave të Islamit”* përkth. Muhammed Zakaria Khan, Tilford, England, 2000.
14. Ebu Zehra, Muhammed, *Tarihul medhahibil islamijje*, Kajro, 1989.

15. Kurejshi, dr. Omer Abdul Aziz, *Usulul fireki*, Kajro, 2005.

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studenti është i obliguar për vijimin e rregullt të ligjëratave dhe ushtrimeve (mbahet evidenca për studentët e rregullt). Të gjithë studentët janë të obliguar t'i përfillin rregullat e mirësjelljes: mbajtja e qetësisë gjatë mësimit, ç'kyçja e telefonave celular, dhe hyrja me kohë në sallë.

Konsultimet:

Orët e konsultimeve mbahen në kabinet sipas orarit të dhënë dhe mund të shfrytëzohet për ndihmë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me lëndën.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë\Javë	Gjithsej
Ligjërata	2	14	28
Ushtrime teorike	1	14	14
Punë praktike	-	-	-
Kontaktime me mësimdhënësin\konsultime	1	14	14
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume, seminare, ese	2	2	4
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	14	28

Përgatitja përfundimtare për provim.	3	2	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste, ese, provim final)	2	2 ditë	4
Totali	14	14 javë	98